



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

V E N D I M

Nr.2507, datë 30.10.2014

Për

**“Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”, Ref. 3-2x5+5-2014”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |    |             |            |         |
|----|-------------|------------|---------|
| 1. | Z. Piro     | Xhixho     | Kryetar |
| 2. | Z. Alban    | Karapici   | Anëtar  |
| 3. | Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar  |
| 4. | Z. Benon    | Paloka     | Anëtar  |
| 5. | Znj. Zamira | Nurçe      | Anëtar  |

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 30.10.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”, Ref. 3-2x5+5-2014”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 19.1 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Raporti përmbledhës i procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.1915/6, datë 09.10.2014
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Njoftimi i fituesit sipas shtojces 16-Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 17- Formulari i Botimit të Fituesit
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Dokumentacioni:

- a) **Raporti përmbledhës** i hartuar nga KVO është në përputhje me pikën 15.10, Kreu III të VKM nr.1252, datë 10.09.2008 "Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave", i ndryshuar;
- b) Procedura e ankimit dhe trajtimit të tyre ka përfunduar.
- c) **Shtojca 16- Formulari i Njoftimit të Fituesit të Tenderit publik** me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz", Ref. 3-2x5+5-2014" është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- d) **Shtojca 17- Formulari i Botimit të Fituesit** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 "Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave", i ndryshuar
- Dokumentin e Tenderit;
- Raportin përmbledhës të procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.1915/6, datë 09.10.2014,

### V E N D O S:

1. Të miratojë Raportin Përmbledhës të KVO-së nr.1915/6, datë 09.10.2014;

2. Të miratojë Njoftimin e Fituesve, sipas dokumenteve bashkëlidhur;
3. Të njoftohen fituesit e tenderit publik me shkresë zyrtare, sipas dokumenteve bashkëlidhur;
4. Të bëhet publikimi i njoftimit të fituesve në faqen e internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al)
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Alketa MUKAVELATI** \_\_\_\_\_
3. **Benon PALOKA** \_\_\_\_\_
4. **Zamira NURÇE** \_\_\_\_\_